

**Identifikimi i Bimëve Mjekësore dhe Aromatike me potencial  
ekonomik në Alpet Shqiptare të Kosovës**

**Intercooperation  
Projekti Zviceran për Promovimin e Hortikulturës në Kosovë**

Përgatitur nga: Prof. Dr. Fadil Millaku

Prishtinë, Tetor 2007



## Abstrakt

Njohja dhe përdorimi i Bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA) është pjesë e kulturës historike të njerëzimit. BMA janë pasuri kombëtare dhe si të tilla duhet të përdorën në interes të njerëzve por gjithmonë duke i përmbush kriteret dhe rregullat e vendeve të zhvilluara. Grumbullimi i BMA pa kriter dhe pa mbikëqyrje nga institucionet përkatëse çon drejt zhdukjes së BMA siç është rasti me ***Gentiana lutea*** në Alpet Shqiptare.

Flora e Alpeve Shqiptare është e shumëllojshme dhe e bujshme në aspektin e BMA. Këtë e ka mundësuar pozita gjeografike, kushtet klimatike, përbërja gjeologjike dhe pedologjike. Këta faktor të rëndësishëm kanë mundësuar që Kosova të këtë bimë mjekësore shumë kualitative në krahasim me të njëjtat lloje që rriten në vende tjera të Evropës së Mesme dhe Veriore.

Alpet Shqiptare të Kosovës si pjesë përbërëse e Dukagjinit përfshin territor nga katër komuna: Istog, Pejë, Deçan dhe Gjakovë. Ky territor përfshinë afro **3 000 km<sup>2</sup>** ose 27 % të territorit të Kosovës. BMA të këtij masivi malor janë të kualitetit të lartë sepse ky rajon është ekologjikisht i pastër dhe përmbush të gjitha kriteret që kërkohen nga Bashkësia Evropiane.

Qëllimi i këtij studimi ka qenë identifikimi i lokaliteteve të pasura me BMA si dhe përgatitja e hartave me të dhëna të mjaftueshme për grumbulluesit dhe kompanitë eksportuese si dhe krijimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe operativ për BMA në rajonin e Dukagjinit dhe me gjerë. Për shkaqe të studimit me të lehtë Alpet Shqiptare i kemi ndarë në katër grupe. Matjet janë bërë sipas Termave të Referencave të caktuara nga Projekti Zviceran për Promovimin e Hortikulturës në Kosovë/PZPHK - “Identifikimi i bimëve mjekësore dhe aromatike, të cilat rriten në mënyrë të egër në natyrë”

Sipërfaqet në hektar me BMA janë caktuar në mënyrë vizuale dhe sasia e tyre në këto lokalitete ku janë bërë matjet është paraqitur me numra nga 5-1, ku:

- Numri 5 paraqet BMA të cila mbulojnë mbi 100 hektar sipërfaqe.
- Numri 4 paraqet BMA të cilat mbulojnë mbi 80 hektar sipërfaqe.
- Numri 3 paraqet BMA të cilat mbulojnë rreth 60 hektar sipërfaqe.
- Numri 2 dhe 1 paraqesin prezencën e një lloji që në ato sipërfaqe është me pakicë.

Në studim janë përfshirë 72 BMA, ndërsa caktimi i lokaliteteve të pasura me BMA është bërë me GPS. Është konstatuar se 25 BMA kanë përhapje të gjerë dhe mbulojnë mbi 1000 hektar, ndërsa 20 lloje mbi 500 hektar. BMA që janë të përhapura në sipërfaqe mbi 1000 ha janë:

*Hypericum perforatum*, *Primula officinalis*, *Achillea millefolium*, *Thymus sp.*, *Carlina acaulis*, *Tussilago farfara*, *Fragaria vesca*, *Vaccinium myrtillus*, *Rubus idaeus*, *Veratrum sp.*, *Epilobium angustifolium*, *Hypericum alpinum*, *Anemone nemorosa*, *Aconitum napelus*, *Geranium macrorrhizum*, *Urtica dioica*, *Juniperus nana*, *Viola tricolor*, *Primula acaulis*, *Rosa sp.*, *Juniperus communis*, *Teucrium chamaedrys*, *Bellis perennis*, *Pinus mugho*, *Juglans regia*.

Për veç këtyre llojeve të evidentuara në Alpet Shqiptare të Kosovës janë të përhapura edhe lloje tjera të cilat edhe pse kanë përhapje me të vogël kanë vitalitet të madh dhe mund të japin masë të mjaftueshme për grumbullim. Lloje të tilla janë ***Petasites hybridus*** dhe ***Petasites albus***.

## I. Hyrje

Me term BMA (bimë mjekësore dhe aromatike) kuptojmë bimët të cilat në organet e tyre vegetative dhe reproduktive përmbajnë materie kimike (aktive) të cilat mund të izoloohen dhe futen në përbërje të medikamenteve të ndryshme që përdoren për shërimin e sëmundjeve të ndryshme.

Përdorimi i BMA në shërimin e sëmundjeve të ndryshme është i vjetër sa edhe vetë njerëzimi. Populli shqiptar ka traditë të mirë në përdorimin e bimëve mjekësore në shërimin e sëmundjeve të ndryshme. Kjo njohuri është trashëguar brez pas brezi që nga koha e Ilirëve. Princi ilir Genci ka përdorur bimë të ndryshme mjekësore për shërimin e sëmundjeve të ndryshme.

Flora e Alpeve Shqiptare është e shumëllojshme dhe e bujshme në aspektin e bimëve mjekësore dhe aromatike. Këtë e ka mundur pozita gjeografike, kushtet klimatike, përbërja gjeologjike dhe pedologjike. Këta faktor të rëndësishëm kanë mundur që Kosova të ketë bimë mjekësore shumë kualitative në krahasim me të njëjtat lloje që rriten në vende tjera të Evropës së Mesme dhe Veriore. Në pyje, livadhe, kullota, vende të pa punuara, afër vendbanimeve, për rreth lumenjve etj rriten me qindra lloje bimore mjekësore dhe aromatike.

Njohja dhe përdorimi i BMA është pjesë e kulturës historike të njerëzimit.

Tendencat që BMA të hidhen nga përdorimi në mjekësinë bashkëkohore kanë mbetur pa sukses, bile në kohet e fundit hulumtimet tregojnë se BEMA mund të përdoren me të madhe në industrinë farmaceutike, kozmetikë, industrinë ushqimore etj.

## II. Sfond

Alpet Shqiptare të Kosovës si pjesë përbërëse e Dukagjinit përfshin territor nga katër komuna: Istog, Pejë, Deçan dhe Gjakovë. Ky territor përfshinë afro 3 000 km<sup>2</sup> ose 27 % të territorit të Kosovës.

Alpet Shqiptare të Kosovës shtrihen në drejtim veri-jug prej Mognës deri të Mali i Batushës në afërsi të Gjakovës në një gjatësi afro 60 km, ndërsa nga perëndimi në drejtim të lindjes zënë një sipërfaqe mbi 40 km.

Pjesa me e madhe e kësaj pasurie i takon sektorit shtetëror e një pjesë me e vogël atij privat.

Para lufte banoret e këtij rajoni janë marrë me shumë me blegtori dhe grumbullim të bimëve mjekësore dhe aromatike. Kështu banoret e komunës së Deçanit kanë siguruar afro 60 % të ardhurave nga këto beshkë.




Fig. 1. Alpet Shqiptare (Kosovë)



Kosovë. Për përcaktimin e BMA në aspektin sasior është përdorë metodë e njëjtë për gjithë Alpet Shqiptare dhe ato janë:

- Janë vizituar vendet e mundshme të pasura BMA në kuadër të Alpeve Shqiptare të Kosovës të cilat janë ndarë në katër grupe ose pjesë.
- Janë bërë matjet me GPS: - kordinatat dhe lartësia mbi detare.
- Është bërë evidentimi i BMA dhe në mënyrë vizuale është caktuar sipërfaqja në hektar për secilin lloj.
- Janë paraqitur me numra nga 5-1 sasia e BMA ku vendi ku është bërë matja përfshinë 5-10 km<sup>2</sup>.
- Sipërfaqet në hektar me BMA janë caktuar në mënyrë vizuale dhe sasia e tyre në këto lokalitete ku janë bërë matjet është paraqitur me numra nga 5-1, ku:
  - Numri 5 paraqet BMA të cila mbulojnë mbi 100 hektar sipërfaqe.
  - Numri 4 paraqet BMA të cilat mbulojnë mbi 80 hektar sipërfaqe.
  - Numri 3 paraqet BMA të cilat mbulojnë rreth 60 hektar sipërfaqe.
  - Numri 2 dhe 1 paraqesin prezencën e një lloji që në ato sipërfaqe është me pakicë.

Për të caktuar numrin e hektarëve me BMA është shumëzuar numri që është përfituar nga matjet sasiore në lokalitete të ndryshme me numrin 20 psh.

Ha	Shuma e P	Emri shkencor
720	36x20= 720	Tussilago farfara

## V. Rezultati i hulumtimit

Rezultatet e këtij hulumtimi janë paraqitur në forme tabelare të ndara në baze ndarjes grupore të Alpeve shqiptare. Në tabela janë përfshirë 72 lloje bimore. Tabela është standarde dhe me lloje të njëjta bimore të identifikuar. Kjo do të mundëson paraqitjen e një pasqyre reale me bimë mjekësore për rajonet e hulumtuara, dhe njëkohësisht do të ketë të dhëna të mjaftueshme për formimin e një harte ku me pika do të paraqiteshin lokalitetet e pasura me BMA dhe do të caktoheshin pikat grumbulluese.

**Në tabela janë dhënë këto shënime:**

1. emri i lokalitetit
2. lartësia mbi detare
3. kordinatat
4. emri shkencor i bimëve
5. emri shqip i bimëve
6. emri serbisht
7. pjesa që përdoret
8. sasia e shprehur në numra nga 5-1.
9. kalendari i vjeljes

### ***Bjeshkët e Istogut (Tabela 1 - matjet 1-27)***

Këto Bjeshkë hyjnë në grupin e I-re të Alpeve shqiptare dhe përfshijnë një sipërfaqe mjaft të madhe duke filluar nga Mali Mokna deri të gryka e Zhlebit. Është territor mjaft i pasur me BMA.

Infrastruktura e keqe pamundëson shfrytëzimin e këtij potenciali me BMA.

Për të konstatuar sasinë e BMA janë bërë 27 matje në pjesë të ndryshme dhe në lartësi të ndryshme mbi detare prej Mognës deri të Maja e Rusolisë.

Në tabelë janë paraqitur BMA që janë të përhapura në zonën kodrinore dhe malore ku edhe janë bërë shumica e matjeve. Duhet të cekët se Shtogu - *Sambucus tigna*, është shumë i përhapur dhe paraqet një potencial të lartë për shfrytëzim. Pasi që matjet janë bërë në zona me të larta, tabela nuk paraqet potencialin e saktë ekonomik të kësaj bime e cila shtrihet në afërsi të fshatrave të këtij rajoni.

<b>BMA në Bjeshkët e Istogut</b>			
	<b>Ha</b>	<b>Shuma e P</b>	<b>Emri shkencor</b>
1	1840	92	Primula officinalis
2	1800	90	Hypericum perforatum
3	1520	76	Achillea millefolium
4	1400	70	Carlina acaulis
5	1200	60	Fragaria vesca
6	1160	58	Rubus idaeus
7	1020	51	Geranium macrorrhizum
8	1000	50	Viola tricolor
9	960	48	Urtica dioica
10	880	44	Thymus sp.
11	780	39	Juniperus communis
12	780	39	Veratrum sp.
13	720	36	Rosa sp.
14	720	36	Tussilago farfara
15	600	30	Orchis morio
16	560	28	Primula acaulis
17	500	25	Anemone nemorosa
18	480	24	Viola odorata
19	460	23	Epilobium angustifolium
20	440	22	Taraxacum officinale
21	380	19	Bellis perennis
22	380	19	Crataegus monogyna
23	360	18	Aconitum napelus
24	360	18	Juniperus nana
25	340	17	Teucrium chamaedrys
26	340	17	Verbascum thapsus
27	300	15	Crocus sp.
28	300	15	Tilia cordata

Nga tabela shihet se BMA me potencial të lartë janë ato nga nr. 1-8 (mbi 1000 ha), pastaj nga 9-17 (mbi 500 ha) dhe BMA nga 18-28 (mbi 300 ha).

### ***Bjeshkët e Gjeravicës (Tabela 2 - matjet 28-35)***

Gjeravica hyn në grupin e IV, është masivi malor më i larti në Kosovë 2656 m. Përfshin një rajon mjaft të gjerë dhe të pasur me BMA. Është rajon mjaft i frekuentuar nga fshataret e komunës së Deçanit dhe Shqipërisë. Përbërja gjeologjike dhe pedologjike është mjaft heterogjene dhe kjo ka mundësuar një pasuri me BMA. Është rajon që në aspektin e vjeljes së BMA shfrytëzohet më të madhe nga banoret e Shqipërisë që jetojnë në afërsi të brezit kufitar dhe shumë pakë nga vendasit e Deçanit.

<b>BMA në Masivin e Gjeravicës</b>			
	<b>Ha</b>	<b>Shuma e P</b>	<b>Emri shkencor</b>
1.	620	31	Vaccinium myrtillus
2.	420	21	Veratrum sp.
3.	400	20	Hypericum alpigenum
4.	360	18	Gentiana punctata
5.	360	18	Juniperus nana
6.	360	18	Thymus sp.
7.	280	14	Achillea millefolium
8.	260	13	Aconitum napelus
9.	240	12	Primula officinalis
10.	160	8	Bellis perennis
11.	100	5	Atropa belladonna
12.	100	5	Epilobium angustifolium
13.	100	5	Hypericum perforatum
14.	100	5	Petasites albus
15.	100	5	Petasites hybridus
16.	100	5	Rubus idaeus
17.	100	5	Tussilago farfara
18.	100	5	Urtica dioica
19.	80	4	Betua pendula
20.	80	4	Fragaria vesca
21.	80	4	Gentiana asclepiadea
22.	80	4	Veronica officinalis
23.	60	3	Anthylis vulneraria
24.	60	3	Carlina acaulis
25.	60	3	Teucrium chamaedrys
26.	60	3	Verbascum thapsus
27.	60	3	Viola tricolor

Nga tab. 2 shihet se BMA me potencial ekonomik janë llojet nga 1-18 me mbi 100 ha. Ky rajon është mjaft i vështirë për tu hulumtuar për 2-3 ditë, mirëpo në bazë të shënime nga Millaku, F (1999) edhe llojet tjera në tab. kanë potencial të lartë ekonomik dhe zënë sipërfaqe shumë me të madhe. Numri i matjeve të bëra është me i vogël se sa në pjesët tjera të Alpeve Shqiptare të Kosovës andaj edhe nr. i hektarëve të mbuluara me këto bimë del me i vogël, pra nuk është i saktë.

### ***Pjesa Veri-Perëndimore e Rugovës (Tabela 3 - matjet 36-50)***

Ky grup i Bjeshkëve hyn në grupin e .II-te dhe shtrihet midis Grykës së Zhlebit dhe Grykës së Rugovës. Përfshinë disa masive malore mjaft të larta nga 2000-2500 m. Është rajon me një florë shumë të pasur dhe me BMA që kanë potencial të lartë ekonomik dhe që shumë pak shfrytëzohen nga popullata e kësaj ane. Për dallim nga pjesët tjera të Alpeve Shqiptare të Kosovës kjo pjesë është me e frekuentuar nga popullata e kësaj ane dhe një pjesë (Rugova) është e populluar nga fshataret.

<b>BMA në pjesën Veri - Perëndimore te Rugovës</b>			
	<b>Ha</b>	<b>Shuma e P</b>	<b>Emri shkencor</b>
1.	1260	63	Hypericum perforatum
2.	820	41	Achillea millefolium
3.	740	37	Tussilago farfara

<b>BMA në pjesën Veri - Perëndimore te Rugovës</b>			
	<b>Ha</b>	<b>Shuma e P</b>	<b>Emri shkencor</b>
4.	660	33	Vaccinium myrtillus
5.	640	32	Primula officinalis
6.	580	29	Anemone nemorosa
7.	460	23	Aconitum napelus
8.	440	22	Thymus sp.
9.	420	21	Epilobium angustifolium
10.	420	21	Primula acaulis
11.	400	20	Hypericum alpigenum
12.	400	20	Rubus fruticosus
13.	360	18	Crataegus monogyna
14.	360	18	Fragaria vesca
15.	360	18	Rosa sp.
16.	340	17	Betua pendula
17.	320	16	Gentiana asclepiadea
18.	320	16	Teucrium chamaedrys
19.	320	16	Veratrum sp.
20.	300	15	Corylus avellana
21.	300	15	Robinia pseudoacacia
22.	260	13	Cornus mas
23.	240	12	Carlina acaulis
24.	220	11	Genista tinctoria
25.	220	11	Orchis morio
26.	220	11	Rubus idaeus
27.	220	11	Verbascum thapsus
28.	200	10	Digitalis lanata
29.	180	9	Galium verum
30.	160	8	Polygonatum odoratum
31.	140	7	Origanum vulgare
32.	140	7	Petasites hybridus
33.	140	7	Pteridium aquilinum
34.	120	6	Asperula odorata
35.	120	6	Mentha longifolia
36.	120	6	Plantago media
37.	100	5	Arctostaphylos uva-ursi
38.	100	5	Atropa belladonna
39.	100	5	Castanea sativa
40.	100	5	Petasites albus
41.	100	5	Salix alba
42.	100	5	Taraxacum officinale

Tabela 3.tregon se llojet nga 1-6 kanë përhapje me shumë së 500 ha, ndërsa llojet nga 7-42 mbi 100 ha. Kjo tregon së kjo pjesë e Alpeve paraqet një diversitet të BMA.

### ***Alpet Qendrore (Tabela 4 - matjet 51-68)***

Alpet Qendrore hyjne ne grupi e III-te dhe shtrihen midis Grykës së Rugovës dhe Grykës së Deçanit duke përfshi disa masive të larta nga 2000- 2500 m. Pozita gjeografike, përbërja gjeologjike dhe pedologjike si dhe kushtet klimatike që zotërojnë në këtë pjesë ka mundësuar një diversitet të florës. Rreth 47 BMA të kësaj zone shtrihen nga zona e ulët deri të zona subalpine dhe alpine. Kjo shifër tregon për pasurin e kësaj pjese me BMA.

<b>Alpet qendrore</b>			
	<b>Hektar</b>	<b>Shuma e P</b>	<b>Emri shkencor</b>
1.	1220	61	Hypericum perforatum
2.	900	45	Thymus sp.
3.	740	37	Tussilago farfara
4.	700	35	Carlina acaulis
5.	680	34	Hypericum alpigenum
6.	680	34	Primula officinalis
7.	620	31	Achillea millefolium
8.	600	30	Epilobium angustifolium
9.	560	28	Digitalis lanata
10.	560	28	Pteridium aquilinum
11.	560	28	Vaccinium myrtillus
12.	500	25	Convallaria majalis
13.	440	22	Bellis perennis
14.	420	21	Fragaria vesca
15.	380	19	Anemone nemorosa
16.	380	19	Cornus mas
17.	380	19	Petasites hybridus
18.	360	18	Gentiana asclepiadea
19.	360	18	Rubus idaeus
20.	360	18	Teucrium chamaedrys
21.	320	16	Juniperus nana
22.	300	15	Polygonatum odoratum
23.	280	14	Corylus avellana
24.	280	14	Mentha longifolia
25.	280	14	Sorbus aucuparia
26.	240	12	Cetraria islandica
27.	240	12	Geranium macrorrhizum
28.	240	12	Juniperus communis
29.	240	12	Rubus fruticosus
30.	220	11	Atropa belladonna
31.	200	10	Petasites albus
32.	200	10	Primula acaulis
33.	180	9	Aconitum napelus
34.	180	9	Centaurium erythrea
35.	180	9	Robinia pseudoacacia
36.	160	8	Juniperus oxycedrus
37.	160	8	Sambucus nigra
38.	160	8	Veronica officinalis
39.	140	7	Frangula alnus

<b>Alpet qendrore</b>			
	<b>Hektar</b>	<b>Shuma e P</b>	<b>Emri shkencor</b>
40.	140	7	Plantago media
41.	140	7	Veratrum sp.
42.	120	6	Anthylis vulneraria
43.	120	6	Tilia cordata
44.	120	6	Verbascum thapsus
45.	100	5	Rosa sp.
46.	100	5	Taraxacum officinale
47.	100	5	Urtica dioica

Nga tab. 4 shihet se BMA nga 1-12 kanë potencial të lartë ekonomik dhe mbulojnë mbi 500 ha. BMA nga 12-47 mbulojnë sipërfaqe mbi 100 hektar që gjithashtu paraqesin një potencial të mirë ekonomik.

### ***BMA që në Alpet Shqiptare të Kosovës mbulojnë mbi 500 hektar***

Tab. 5. paraqet BMA që kanë potencialin me të lartë dhe që nga numri 1-23 kanë përhapje në sipërfaqe mbi 1000 hektar, ndërsa BMA nga 24-42 mbi 500 ha. prandaj grumbullimi i tyre në sasi të mëdha ashtu siç kërkon tregu Evropian dhe me gjerë është i mundshëm.

	<b>Hektar</b>	<b>Shuma e P</b>	<b>Emri shkencor</b>	<b>Emri shqip</b>
1	4480	224	Hypericum perforatum	Lulebasami
2	3500	175	Primula officinalis	Aguliqja mjekësore
3	3240	162	Achillea millefolium	Bar pezmi
4	2640	132	Thymus sp.	Krasta
5	2400	120	Carlina acaulis	Ushojëza pa kërcell
6	2400	120	Tussilago farfara	Thundër mushka
7	2140	107	Fragaria vesca, F.moschata	Dredhëza
8	2020	101	Vaccinium myrtillus	Boronica
9	1840	92	Rubus idaeus	Mjedra
10	1660	83	Veratrum sp.	Shtara
11	1580	79	Epilobium angustifolium	Epilob
12	1480	74	Hypericum alpigenum	Lulebasami alpik
13	1460	73	Anemone nemorosa	Fillikatja e pyllit
14	1260	63	Aconitum napelus	Pelini
15	1260	63	Geranium macrorrhizum	Kamaroshja rrenjemadhe
16	1240	62	Urtica dioica	Hithra
17	1200	60	Juniperus nana	Dëllinja e rregjuar
18	1200	60	Viola tricolor	Manushaqe trengjyrëshe
19	1180	59	Primula acaulis	Aguliqja pa kërcell
20	1180	59	Rosa sp.	Trendafil i egër
21	1100	55	Juniperus communis	Dëllinja e zezë
22	1080	54	Teucrium chamaedrys	Arresi dushkvoçel
23	1020	51	Bellis perennis	Lule shqerre
24	980	49	Pteridium aquilinum	Fieri i shqipës
25	920	46	Gentiana asclepiadea	Gentiana e Asklepit
26	900	45	Orchis morio	Salep
27	860	43	Corylus avellana	Lajthia

	Hektar	Shuma e P	Emri shkencor	Emri shqip
28	820	41	Convollaria majalis	Lotëzonja
29	820	41	Crataegus monogyna	Murrizi
30	760	38	Cornus mas	Thana
31	760	38	Digitalis lanata	Lule togeza
32	760	38	Rubus fruticosus	Manaferra
33	740	37	Verbascum thapsus	Netull
34	720	36	Gentiana punctata	Gentiana pikaloshe
35	700	35	Petasites hybridus	Lapua hibrid
36	640	32	Taraxacum officinale	Lule shurdha
37	620	31	Viola odorata	Manushaqja
38	580	29	Betua pendula	Mështekna
39	580	29	Polygonatum odoratum	Poligonati
40	580	29	Robinia pseudoacacia	Bagremi
41	540	27	Atropa belladonna	Helmarina
42	500	25	<b>Tilia cordata</b>	<b>Bliri</b>

## VI. Këshilla për fermer

Për shfrytëzimin e drejtë të BMA duhet njohur:

- bimët,
- pjesët që përdoren,
- duhet ditur kalendari i vjeljes,
- teknikat e vjeljes (grumbullimit) dhe
- mënyrat e terjes dhe përgatitjes për eksport.

**Nuk janë të gjitha organet bimore njësoi shëruese**, andaj detyrë parësore e grumbulluesve të BMA është të kenë njohuri të duhura të:

- identifikojnë BMA
- dinë cili organ i cilës BMA duhet mbledhur,
- dinë kur është koha më e përshtatshme që të kryhet vjelja, kalendari i vjeljes
- si duhet të bëhet vjelja e këtyre organeve bimore në mënyrë që mos të rrezikohen bimët nga zhdukja.
- si bëhet terja dhe staxhionimi i tyre
- si bëhet etiketimi dhe çfarë duhet përmbaj etiketa.

### **Njohja e BMA është mjaft e ndërlikuar!**

Personat që merren me grumbullimin e BMA duhet të kenë njohuri elementare lidhur me këtë biznes andaj:

- është më rëndësi njohja e bimëve shëruese, aromatike dhe helmuese.
- shtrirja gjeografike, pamja e bimës, përbërja kimike, dukja e drogave,
- përdorimi i tyre në aspektin shkencor dhe popullor.

## Vjelja

- Bimët mjekësore dhe aromatike duhet të vilen në kohën kur përmbajnë maksimumin e materieve aktive.
- Duhet të vilen në kohë të mirë dhe jo me shi ose mjegull ose kur ka vesë.
- Bimët e vjelura nuk guxojnë të qëndrojnë në qese ose thasë me shumë se 2-3 orë.
- Për ta përcaktuar këtë kohë duhet të përcaktohen **substancat aktive** që përmban bima në periudhat e ndryshme të vegetacionit.
- Koha e vjeljes ndryshon sipas llojeve bimore, sipas pjesëve të ndryshme të së njëjtës bimë dhe sipas vendit.
- Në praktikë vjelja e bimëve nuk bëhet në kohën e duhur, si pasojë e kushteve atmosferike. Kalendari i vjeljes është dhënë në tabelën nr.

## Kalendari i vjeljes

Emri shkencor	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Hypericum perforatum					■	■	■						herba
Primula officinalis				■	■	■							lulja
Achillea millefolium				■	■	■	■	■					herba
Thymus sp.				■	■	■	■	■					herba
Carlina acaulis								■	■	■			rrenja
Tussilago farfara			■	■		■	■						lulja+gjethi
Fragaria vesca				■	■	■				■	■		fruti+gjethi
Vaccinium myrtillus							■	■					fruti
Rubus idaeus							■	■					fruti
Veratrum sp.									■	■	■		rrenja
Epilobium angustifolium						■	■	■					herba
Hypericum alpigenum							■	■					herba
Anemone nemorosa				■	■		■	■	■				herba+rrenja
Aconitum sp.								■	■	■			rrenja
Geranium macrorrhizum						■	■		■	■			herba+rrenja
Urtica dioica					■	■			■	■			herba +rrenja
Juniperus nana									■	■			fruti
Viola tricolor					■	■	■	■					herba
Primula acaulis			■	■	■								lulja
Rosa sp.									■	■			fruti
Juniperus communis									■	■			fruti
Teucrium chamaedrys						■	■	■					herba
Bellis perennis					■	■	■						lulja
Pteridium aquilinum								■	■	■			rizoma
Gentiana asclepiadea									■	■	■		rizoma
Orchis morio						■	■						bulbi
Corylus avellana							■	■					fruti
Convallaria majalis					■	■							total
Crataegus monogyna				■	■					■	■	■	lulja+fruti
Cornus mas									■	■	■		fruti
Digitalis lanata					■	■	■	■	■	■			gjethi+fara
Rubus fruticosus					■	■	■	■					fruti+gjethi
Verbascum thapsus				■	■	■	■	■					lulja+gjethi
Gentiana punctata							■	■					rizoma

Emri shkencor	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Petasites hybridus									■	■			rizoma
Taraxacum officinale					■	■				■	■		gjethi+rrenja
Viola odorata				■	■				■	■	■		tot.+lulja
Betua pendula		■	■		■	■							gjethi+cortex
Polygonatum odoratum				■	■	■							herba
Robinia pseudoacacia				■	■								lulja
Atropa belladonna					■	■	■	■	■	■	■		gjethi+fruti
Tilia sp.						■			■	■			lulja+cortex
Mentha longifolia					■	■	■						gjethi
Plantago media						■	■	■	■				gjethi
Sambucus tigr				■	■	■			■	■			lulja+fruti
Asperula odorata				■	■								herba
Sorbus aucuparia								■	■				fruti
Cetraria islandica						■	■						herba
Genista tinctoria						■	■						herba
Petasites albus				■	■				■	■			gjethi+rizoma
Centaurium umbellatum					■	■	■						herba
Frangula anus							■	■	■				cortex
Crocus sp.		■	■	■									lulja
Fraxinus ornus				■	■								lulja
Veronica officinalis						■	■	■					herba
Origanum vulgare							■	■					herba
Galium verum						■	■	■					herba
Sanguisorba minor				■	■	■							herba
Hedera helix				■	■								gjethi
Prunus spicosa				■	■			■	■	■			lulja+fruti
Anthylis vulneraria						■	■						herba
Juniperus oxycedrus								■	■	■			fruti
Antennaria dioica						■	■						herba
Castanea sativa				■	■				■	■			gjethi+fruti
Cichorium intibus						■	■		■	■	■		lulja+rrenja
Colchicum autumnale						■	■	■	■				total
Malus sylvestris							■	■	■	■			fruti
Tanacetum vulgare						■	■	■	■				herba
Arctostaphylos uva-ursi			■	■	■	■	■	■	■	■	■		gjethi
Pyrus sp.								■	■				fruti
Salix alba			■	■							■	■	Cortex

Legjenda	
herba+total	■
Lulja	■
Rrenja+rizoma	■
Gjethi	■
Fruti	■
Bulbi	■
Fara	■
Cortex	■

## ***Tharja e bimëve***

Është punë mjaft delikate, që duhet të bëhet shpejtë dhe me kujdes, por e domosdoshme në konservimin e tyre.

Tharja bëhet me qellim që:

- bimëve të ju hiqet uji
- bimët të mbrohen nga mikroorganizmat
- të ndërpritet veprimi i enzimave

Tharja e bimëve mjekësore dhe aromatike mund të bëhet në:

- ajër
- diell
- furra

## ***Kultivimi BMA***

**Sa ka kushte në kultivimin e bimëve mjekësore e aromatike në rrethin e Dukagjinit?**

Rajoni i Dukagjinit është rajoni me i përshtatshëm për kultivimin e BEMA në Kosovë.

Ka klimë të favorshme, tokë adekuate, ujë të mjaftueshëm.

**Cilat janë anët pozitive të kultivimit:**

**Kultivimi i BMA:**

- Siguron rendimente të larta
- Lehtëson dhe shpejton vjeljen.
- Siguron material të pastër dhe me përmbajtje me të qëndrueshme të substancave aktive.
- Krijon mundësitë për një planifikim të saktë.
- Shfrytëzohen toka që nuk mund të shfrytëzohen për kultura tjera.
- Siguron shfrytëzimin e atyre bimëve mjekësore e aromatike, që nuk mund të zhvillohen në gjendje të egër.

## **Konkluzat**

- Alpet Shqiptare të Kosovës janë të pa ndotura dhe ekologjike.
- Rajoni i hulumtuar është mjaft i pasur me bimë mjekësore.
- Përqindja e popullatës urbane që merren me grumbullim të këtyre bimëve është shumë e vogël.
- Ekzistojnë shumë pak njohuri të popullata urbane lidhur me bimët mjekësore dhe përfitimet që mund të vijjnë nga grumbullimi dhe shitja e tyre.
- Çmimet e grumbullimit sipas grumbulluesve ndryshojnë brenda ditës, dhe kjo dekurajon mbledhësit sepse janë të pasigurt në plasman.
- Në bazë të informatave të marra në terren përfitime me të mira kanë në grumbullimin e kërpudhave.
- Nga lista e bimëve mjekësore ofrohet ofertë vetëm për disa lloje bimore
- Mungojnë informatat lidhur me terjen që mund të bëhet nën hije ose në diell për lloje të caktuara.
- Duhet bërë analiza laboratorike e BMA që nuk grumbullohen ende.
- Gështenja *Castanea sativa* është lloji me potencial me të madhin ekonomik që është e përhapur nga Morina deri të Gryka e Rugovës.
- Dredhaku *Pinus mugho* është lloj gjithashtu shumë i përhapur që mbulon zonat mbi 1800-2200 m.
- Rajoni me organizim me të mirë ishte rajoni i Istogut.

## ***Vërejtje***

- Gështënja ( *Castanea sativa*) është bima që ka potencialin me të lartë ekonomik sepse mbulon sipërfaqe nga Morina deri të Gryka e Rugovës. Të dhëna të sakta për këtë lloj do të bëhen gjat matjeve në vitin e ardhshëm.
- Shtogu (*Sambucus nigra*) është bimë me potencial të lartë ekonomik që mbulon sipërfaqe të konsiderueshme por pasi gjendet rrëzë malit dhe në vende urbane nuk janë bërë matje në lokalitetet ku është prezent. Të dhëna të sakta për këtë lloj do të bëhen gjatë matjeve në vitin e ardhshëm.
- **Grupi I.** Bjeshkët e Istogut është mbuluar dhe hulumtuar në tërësi, me ç'rast janë bërë matjet dhe janë evidentuar në aspektin sasior BMA.
- **Grupi II.** është hulumtuar në pjesën me të madhe. Gjatë hulumtimit të rajonit nga Zhlebi deri të Gryka e Rugovës ka mbetur pa hulumtuar vetëm Lipa dhe Sushica.
- **Grupi III.** Prej Grykës së Rugovës deri të Gryka e Deçanit nuk janë hulumtuar këto pjesë: Maja e Strellcit, Maja e Balajve
- **Grupi IV.** Prej Grykës së Deçanit deri të Qafa e Morinës nuk janë hulumtuar: Gryka e Lloçanit, Bjeshka e Belegut, Marjashi, Kurvalla, Ropsi, Rrasa e Zogut, Maja e Zezë.

# Shtojca 1

## Termet e Referencës

### Identifikimi i bimëve medicinave dhe aromatike me potencial për eksport

---

(kulturat/llojet e përfshira, janë bimë medicinale dhe aromatike, të cilat rriten në mënyrë të egër në natyrë, dhe në këtë dokument ato do të njihen si “bimët”)

#### Informata bazë

Kosova ka traditë të gjatë në grumbullimin e bimëve të egra medicinave dhe aromatike (BMA) – grumbullimi dhe marketingu i tyre në ish-Jugosllavi është kryer nga një rrjet mirë i zhvilluar i kooperativave bujqësore, dhe kryesisht janë shitur përpunuesve në Slloveni, Kroaci, Serbi dhe është eksportuar edhe në Gjermani. Në kultivim nuk ka pas traditë.

Luftërat në ish Jugosllavi i kanë shkëputur të gjitha lidhjet dhe kanalet e shitjes, dhe për këtë, në 2002, nuk ka pas fare grumbullim komercial në Kosovë. Megjithatë, tre përpunues të vegjël, patën filluar të prodhojnë filtër qeska, për 15-20 lloje, me lëndë të parë të importuar, duke përfshirë kulturat e kultivuara sikur kamomili, menta, mëllaga e bardh dhe melisa, si dhe bimëve të egra t bimëve të egra grumbulluara sikur bliri, hithri, kaça dhe shtogu.

Një studim ndërkombëtar në 2002, duke u vazhduar me një takim pune me përfshirjen e aktorëve të sektorit, ka identifikuar potencialin e këtij nën sektori në krijimin e një numri të konsiderueshme të vendeve të punës dhe të ardhurave në zonat rurale. Konsiderohet se Kosova ka potencial për eksport të BMA në tregun Evropës Perëndimore – por për këtë nevojiten sasi të mëdha për ta josh një treg të tillë – problem i madh fillestar për ta rinis këtë nën sektori nga fillimi. Një sasi e BMA është eksportuar në Gjermani dhe vendet fqinje, por e vogël në krejt kjo në baza individuale pa ndonjë organizim.

#### Qëllimi i këtij studimi

PZPH-K ka mbështet industrinë e BMA për katër vite, përmes ndihmës së dhënë fermerëve në (i) kultivimin e BMA, kryesisht në Komunën e Istog-ut dhe që nga viti i kaluar edhe tri Komuna tjera – Dragash, Rahovec dhe Vushtri, dhe (ii) në përpunim, duke dhuruar tharëse dhe makina përpunuese; duke konsideruar si mundësi tregu për kulturat e kultivuara ndërmarrjet që prodhojnë filtër qeska dhe jo eksportin e kulturave të grumbulluara.

Vitin e kaluar, klienti kryesor i projektit “Agroprodukti” ka eksportuar pesë kultura. Në vlerë prej 50.000 €, përmes një agjenti tregtar të Kompanisë më të madhe në botë për BMA “Martin Bauer”, Gjermani. Para eksportimit janë kryer analizat e kimike në Kosovë dhe në Gjermani. Kjo mënyrë zyrtare e eksportimit na shtynë të besojmë se kjo “derë” është e hapur.

Projekti në bashkëpunim me KCBS dhe GTZ dëshiron të kontribuon të krijoj mundësi për grumbullim dhe t’i përmisoj lidhjet ndërmjet aktorëve të ndryshëm të përfshir në grumbullim. Është ndër nevoja për një studim për identifikimin e bimëve me potencial për eksport, si bazë për ndërtimin e strategjive në të ardhmen.

#### Rezultatet e pritura dhe përfundimet e studimit

Konsulenti duhet të ofroj:

- listën me BMA që gjendet në sasi komerciale (p.sh. me së paku 100 ha) në Kosovë;
- për secilën BMA të identifikuar, të jepen informata, si më poshtë:
  - emrin (në Shqip, Anglisht, Latinisht .....);
  - karakteristikat e rritjes/zhvillimit (.....);

- pjesët e bimës me interes ekonomik;
- për çka përdoret ajo pjesë;
- teknikat e grumbullimit dhe përpunimit fillestar;
- periudha e grumbullimit.
- së paku 5 fotografi digjitale të kualitetit të mirë, me pjesët më interesante të bimës (bima në natyrë, bima e shkullur, lulja, fara, rrënja dhe bima e tharë)
- listën e Komunave ku gjinden BMA në sasi komerciale (së paku 10 ha), dhe parallogaritja se sa është sipërfaqja e mbuluar me ato në hektar (me këto informata do të mund të krijohej një hartë);
- kalendarin e grumbullimit;
- listën e kontakteve (personave) të bëra gjatë studimit, (profesionet, adresat, numrat e telefonave). Për individët me rëndësi, të shpjegohet rëndësia e tyre për sektorin;
- një udhërrëfyes praktik për praktikantët më të mira të grumbullimit në përgjithësi, për qëndrueshmërinë ekologjike dhe për të siguruar kualitetin më të lart të produktit përfundimtar;
- rekomandime rreth mënyrave të promovimit të zhvillimit të sektorit të grumbullimit të BMA.

Produkt final do të jetë një manual/katalog duke përfshirë çka e tha më lart dhe fotografit, si dhe të jetë në të shkruar dhe elektronik

#### Aranzimet logjistike



- Raporti të paraqitet në të shkruar dhe elektronik (duke përfshi edhe fotografit)



## Shtojca 2 - Emrat e llojeve te MAP prezente në Alpet Shqiptare



Emri			
Shkencor	Shqip	Anglisht	Serbisht
Achillea millefolium	Bar pezmi	Yarrow	Stolisnik
Aconitum napelus	Pelini	Aconite	Jedic
Anemone nemorosa	Fillikatja e pyllit	Wood Anemone	Bela sasa
Antennaria dioica	Antenaria dioike	Cat's-foot	Srcopuc
Anthylis vulneraria	Antilida	Lady's finger	Vulneraria
Arctostaphylos uva-ursi	Rrusharusha	Bearberry	Medvjetka
Asperula odorata	Njegjira	Woodruff-asperule	Lazarkinja
Atropa belladonna	Helmarina	Banewort	Belebile
Bellis perennis	Lule shqerre	Daisy	Krasuljak
Betula pendula	Mështekna	Silver Birch	Breza
Carlina acaulis	Ushojëza pa kërcell	Carlina	Kravljak
Castanea sativa	Gështënja	Sweet Chestnut	Kesten
Centaureum erythraea	Bar ethësh	Common Centaury	Gorcica
Cetraria islandica	Ushojëza pa kërcell	Island Cetraria	Islandiski lisaj
Cichorium intibus	Bresa	Chicory	Cikori
Colchicum autumnale	Gjerokulli	Meadow Saffron	Mrazovac
Convallaria majalis	Lotëzonja	Lily-of-the Valley	Djurdjevack
Cornus mas	Thana	Cornell-tree	Drijen
Corylus avellana	Lajthia	Hazell	Lijeska
Crataegus monogyna	Murrizi	Witethorn	Bijeli glog
Crocus sp.	Krokusi	Saffron	Safran
Digitalis lanata	Lule togeza	Grecian Foxglove	Digital
Epilobium angustifolium	Epilob	Fireweed	Vrbovica
Fragaria vesca	Dredhëza	Wild Strawberry	Sumska pagoda
Frangula alnus	Tulkuqi,zogla	Alder	Krusina
Fraxinus ornus	Frasheri	Flowering Ash	Crni jasen
Galium verum	Ngjitsja e vertetë	Yellow Galium	Zuta brocika
Genista tinctoria	Gjinestër	Dyer's Greenweed	Zhutilica
Gentiana asclepiadea	Gentiana e Asklepit	Gentian	Lincurr
Gentiana punctata	Gentiana pikaloshë	Dotted-flowered Gentian	Lincurr
Geranium macrorrhizum	Kamaroshja rrenjemadhe	Cranesbil	Zdravac
Hedera helix	Urthi	Bindwood	Brshljan
Hypericum alpigenum	Lulebasami alpik	Common Alp	Kantarion
Hypericum perforatum	Lulebasami	Common	Kantarion
Juniperus communis	Dëllinja e zezë	Juniper	Borovica
Juniperus nana	Dëllinja e rregjuar	Juniper	Borovica
Juniperus oxycedrus	Dëllinja e kuqe	Juniper	Smrika
Malus sylvestris	Molla e eger	Wild Apple	Divlja pabuka
Mentha longifolia	Menta	Mint	Metvica
Orchis morio	Salep	Orchis	Kacun
Origanum vulgare	Qaj mali	Wild Marjoran	Mravinac
Petasites albus	Lapua i bardhë	Butterbur	Bijeli lopuh
Petasites hybridus	Lapua hibrid	Butterbur	Crveni lopuh
Plantago media	Cemerdelli	Hoary Plantain	Srednji trputac



<b>Emri</b>			
<b>Shkencor</b>	<b>Shqip</b>	<b>Anglisht</b>	<b>Serbisht</b>
Polygonatum odoratum	Poligonati	Angular Solomon's seal	Pokosnica
Primula acaulis	Aguliqja pa kërcell	Primrose	Jagorcika
Primula officinalis	Aguliqja mjekësore	Cowslip	Rani jaglac
Prunus spinosa	Kulumria	Sloe	Trn
Pteridium aquilinum	Fieri i shqipës	Bracken	Bujad
Pyrus sp.	Dardha e egër	Wild Pear	Divlja kruska
Robinia pseudoacacia	Bagremi	Yellow Lokust	Bagrem
Rosa sp.	Trendafil i egër	Dog Rose	Divlja ruza
Rubus fruticosus	Manaferra	Dewberry	Kupina
Rubus idaeus	Mjedra	Raspberry	Malina
Salix alba	Shelgu	White Willow	Bela vrba
Sambucus nigra	Shtogu	Elder	Crna bazga
Sanguisorba minor	Sanguisorbë e vogël	Salad Burned	Dinjica
Sorbus aucuparia	Vadha e eger	Roman	Jarebika
Tanacetum vulgare	Karajpeli	Tansy	Vratic
Taraxacum officinale	Lule shurdha	Blowball	Maslacak
Teucrium chamaedrys	Arresi dushkvoçel	Common Germander	Dubicac
Thymus sp.	Krasta	Wild Thyme	Majcina dusica
Tilia cordata	Bliri	Lime	Lipa
Tussilago farfara	Thundër mushka	Horse Weed	Konjska kopita
Urtica dioica	Hithra	Stinging Nettle	Kupriva
Vaccinium myrtillus	Boronica	Bilberry	Borovnica
Veratrum sp.	Shtara	Falsehellebore	Cemerika
Verbascum thapsus	Netull	Wool Mullein	Divizma
Veronica officinalis	Veronik	Common Speedwell	Veronika
Viola odorata	Manushaqja	Sweet Violet	Ljubica
Viola tricolor	Manushaqe trengjyrëshe	Wild Pansy	Sarena ljubicica

### Shtojca 3 - Hartat e llojeve qe janë prezent mbi 2000 ha ne alpet shqiptare









## **Shtojca 4 - Personat kontaktues që ndihmuan në realizimin e këtij projekti:**

**Grupi I. Bjeshkët e Istogut:** Halit Avdijaj – është personi me i përkushtuar në zhvillimin e kësaj veprimtarie. Ndihmon shumë individ me informacione të nevojshme lidhur me llojet e BMA që ka mundësi të shiten në treg, metodat e vjeljes, grumbullimit, tharjes etj.

### **Grupi II.:**

Mustafë Krasniqi fon: 044 365088,  
Miftar Millaku 044 232 717 dhe  
Muhamet Gashi 044 203 145 - që të tre pylltar të këtij rajoni.

**Grupi III :** Sylejman Dervishi dhe Ukë Maloku 044 220890 pjesëtar të TMK.

**Grupi IV. Gjeravicë:** Behxhet Berisha 044 287 692 bberisha @hotmail. com, Ferat Rexhepi 044 226 478 feratrexhepi@yahoo.com, Ismet Kuqi.

### **Në bazë të informatave të mbledhura nga terreni:**

- Bjeshkët që i takojnë komunës së Istogut shfrytëzohen me shumë në aspektin e grumbullimit të BMA në krahasim me pjesët tjera të Alpeve Shqiptare.
- Këtë e ka mundësuar qendra e grumbullimit të BMA në fshatin Syne pronar i së cilës është Halit Avdijaj.
- Në pjesët tjera të Alpeve, me shumicë vjelët vetëm boronica edhe pse këto pjesë janë të pasura me BMA.

## Shtojca 5 – Literatura

- Braun Blanquet, J. (1964): Pflanzensoziozoologie, Springer verlag. Wien-New York.
- Demiri, M. (1983): Flora Eskursioniste e Shqipërisë, Shtep. Bot. Tiranë
- Millaku, F. (1993): Flora e Majës së Rusolisë (mscr), sveuc. Zagreb.
- Millaku, F. (1997): Endemiket e Ballkanit dhe të Kosovës në Florën e Majës së Rusolisë, Bioteknologjia, 1,127-133. Fak. i Bujqësisë, Prishtinë.
- Millaku, F. (1999): Flora subalpike dhe alpike e Alpeve Shqiptare (Kosovë), (mscr.), tema e Doktoratës, Prishtinë.
- Rexhepi, F. (2003) : Bimët Mjekësore, FSHMN, USAID, Prishtinë
- Tutin, T.G. et V.H. Heywood (ed.) 1964-1980: Flora Europaea, 1-5, Cambridge.